



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 01/50

Datë: 23.09.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 23 Shtator 2015, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Koncept-dokumenti për Transfuzionin e gjakut, kontrollin e gjakut dhe produktet e tij.
2. Obligohet Ministria e Shëndetësisë dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Isa MUSTAFA**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 02/50

Datë: 23.09.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-111 dhe Ligjin nr. 05/L-009, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjesisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 23 Shtator 2015, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Qeveria e Republikës së Kosovës, për drejtorë në bordin e Ndërmarrjes Publike, Kompania për Menaxhimin e Deponive Sh. A., emëron këta kandidatë:
  - 1.1. Lundrim Camaj, Kryesues;
  - 1.2. Xhavit Hasani;
  - 1.3. Hafiz Krasniqi;
  - 1.4. Goran Lazic;
  - 1.5. Nexhat Berisha;
  - 1.6. Gazmend Bytyçi.
2. Të emëruarit nga pika 1. e këtij vendimi kryejnë detyra dhe përgjegjësi në pajtim me Ligjin nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-111 dhe Ligjin nr. 05/L-009, si dhe legjislacionin tjetër përkatës në fuqi.
3. Mandati i të emëruarve nga pika 1. e këtij vendimi, zgjatë tre (3) vite.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Isa MUSTAFA**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 03/50


Datë: 23.09.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 4 paragrafi 2. të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjesisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 23 Shtator 2015, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet në parim Nisma për lidhjen e Marrëveshjes në mes të Suedisë dhe Republikës së Kosovës, mbi bashkëpunimin për reforma.
2. Obligohet Ministria e Integritit Evropian të ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshëm në përputhje me legjislacionin në fuqi, me qëllim të finalizimit të tekstit përfundimtar të marrëveshjes së lartcekur.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**Isa MUSTAFA**

  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 04/50

Datë: 23.09.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 4 paragrafi 2. të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 23 Shtator 2015, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet në parim Nisma për lidhjen e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Mbretërisë së Danimarkës, për Transport rrugor ndërkombëtar të udhëtarëve dhe mallrave.
2. Obligohet Ministria e Infrastrukturës që të zhvilloj negociata me Qeverinë e Mbretërisë së Danimarkës, me qëllim të finalizimit të tekstit përfundimtar të marrëveshjes së lartcekur, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**Isa MUSTAFA**

\_\_\_\_\_  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 05/50

Datë: 23.09.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 4 paragrafi 2. të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 23 Shtator 2015, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet në parim Nisma për lidhjen e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Mbretërisë së Holandës, për Transport rrugor ndërkombëtar të udhëtarëve dhe mallrave.
2. Obligohet Ministria e Infrastrukturës që të zhvilloj negociata me Qeverinë e Mbretërisë së Holandës, me qëllim të finalizimit të tekstit përfundimtar të marrëveshjes së lartcekur, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**Isa MUSTAFA**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 06/50

Datë: 23.09.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 4 paragrafi 2. të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësive administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 23 Shtator 2015, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet në parim Nisma për lidhjen e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Dukatës së Madhe të Luksemburgut, për Transport rrugor ndërkombëtar të udhëtarëve dhe mallrave.
2. Obligohet Ministria e Infrastrukturës që të zhvilloj negociata me Qeverinë e Dukatës së Madhe të Luksemburgut, me qëllim të finalizimit të tekstit përfundimtar të marrëveshjes së lartcekur, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**Isa MUSTAFA**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 07/50

Datë: 23.09.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 23 Shtator 2015, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Ndahen mjete financiare në vlerë prej 25,000 (njëzetepesëmijë) euro për festimin e ditës së komunitetit boshnjak të Republikës së Kosovës.
2. Mjetet financiare nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga buxheti i Zyrës për Çështje të Komuniteteve të Zyrës së Kryeministrit, kodi programor 15600 dhe barten në Zyrën e Ministrit pa portofol z. Rasim Demiri.
3. Autorizohet Ministri pa portofol z. Rasim Demiri për themelimin e Këshillit organizativ për shënimin e ditës së komunitetit boshnjak të Republikës së Kosovës, e cila mbahet me datë 28 Shtator 2015.
4. Obligohet Ministri pa portofol dhe Zyra e Kryeministrit për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Isa MUSTAFA**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 08/50

Datë: 23.09.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 23 Shtator 2015, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet në parim Nisma për lidhjen e Marrëveshjes Financiare për IPA 2012, me ndryshimet e paraqitura në aneksin e Marrëveshjes, në pikën 06-2012/2, dhe Nisma për lidhjen e Marrëveshjes Financiare IPA 2013, me ndryshimet e paraqitura në aneksin e Marrëveshjes, në pikën 04-2013/02, në mes të Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian.
2. Obligohet Ministria e Integritimit Evropian që të ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshëm, në përputhje me legjislacionin në fuqi, me qëllim të finalizimit të tekstit përfundimtar të marrëveshjeve të lartcekura.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**Isa MUSTAFA**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 09/50

Datë: 23.09.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 paragrafi 5 të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 23 Shtator 2015, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet propozimi i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për t'i rekomanduar Presidentes së Republikës së Kosovës, për autorizimin e Ministrit të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, për nënshkrimin e Marrëveshjes për themelimin e Qendrës së Ballkanit Perëndimor për hulumtime dhe inovacione.
2. I Rekomandohet Presidentes së Republikës së Kosovës për dhënien e autorizimit për nënshkrimin e marrëveshjes nga paragrafi 1. i këtij vendimi, konform afatit të përcaktuar në nenin 7 të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**Isa MUSTAFA**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 10/50

Datë: 23.09.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 11 dhe nenit 45 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 23 Shtator 2015, nxjerr këtë:

**V E N D I M - P Ë R F U N D I M T A R**

1. Aprovohet shpronësimi për interes publik i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit, të cilat preken nga ndërtimi i Qendrës Turistike Brezovica, Zonat Kadastrale: Vërbeshtica, Berofc II, Jazhincë, Gotovusha dhe Shtërpcë të Komunës së Shtërpcës, sipas tabelave të bashkëngjitura këtij vendimi.
2. Brenda 5 (pesë) ditëve të punës pas nxjerrjes së këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit/MMPH, i dërgon vendimin subjektit kërkues dhe personave të tjerë të identifikuar në tabelat e përcaktuara në pikën 1. të këtij vendimi.
3. Brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit/MMPH bënë shpalljen e vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë ditore me tirazh të madh në Kosovë.
4. Pjesë integrale e këtij vendimi është akti i vlerësimit i punuar nga Zyra për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme/Ministria e Financave dhe tabelat të bashkëngjitura këtij vendimi në të cilat është përcaktuar shuma e kompensimit për ata pronarë apo zotërues të interesit, të drejtat pronësore ose interesat e ligjshme të cilëve iu janë prekur nga procesi i shpronësimit.
5. Kundër këtij vendimi, subjekti kërkues, cilido person i cili është pronar ose zotërues i interesit, në pronën e paluajtshme ose të drejtat pronësore të prekura nga ky vendim, si dhe çdo person i interesuar i cili ka një interes legjitim të drejtpërdrejtë dhe material në pronën e paluajtshme, e cila është objekt i vendimit përfundimtar, pavarësisht nëse është identifikuar apo jo në tabelat e bashkëngjitura të këtij vendimi, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditëve kalendarike kanë të drejtë për të ushtruar ankesë pranë Gjykatës Kompetente, vetëm sa i përket lartësisë së shumës së kompensimit, të përcaktuar me këtë vendim.
6. Brenda pesë (5) ditëve kalendarike pas dorëzimit të ankesës në gjykatën kompetente parashtruesi i ankesës duhet të sigurojë që pesë (5) kopje të ankesës të dorëzohen fizikisht në zyrën ligjore të Organit përkatës Shpronësues.

7. Brenda dy (2) viteve nga data e hyrjes në fuqi të vendimit, Departamenti i Shpronësimit në kuadër të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor do të paguajë plotësisht shumën e kompensimit të shpronësimit, të përcaktuar me këtë vendim.
8. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Republikën e Kosovës.

**Isa MUSTAFA**

\_\_\_\_\_  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 11/50

Datë: 23.09.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 18 të Ligjit Nr. 04/L-261 për Veteranët e Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjesisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Vendimit Nr. 28/2015 të Ministrisë së Financave, datë 22.09.2015, për propozim të shumës së pensionit të Veteranit Luftëtar të UÇK-së, në mbledhjen e mbajtur më 23 Shtator 2015, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Përcaktohet shuma e pensionit për Veteranët Luftëtar të UÇK-së, në vlerat si vijon:
  - 1.1. 130.00 (njëqindetridhjetë) euro për Veteranët Luftëtar të UÇK-së, deri në moshën 35 vjeçare;
  - 1.2. 170.00 (njëqindeshatëdhjetë) euro për Veteranët Luftëtar të UÇK-së, mbi moshën 35 vjeçare.
2. Obligohet Ministria e Financave dhe Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**Isa MUSTAFA**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë